



GJAKOVA



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**

**01 Nr. \_\_\_\_\_ /2026**

**Dt.30.04.2026**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 , nenin 18.2 shkronja e të Statutit të Komunës së Gjakovës, dhe në nenin 5.2 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026, pas diskutimeve lidhur më pikën e 8 të rendit të ditës: Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve ” SH. A Gjakovë, e miratoi këtë :

**V E N D I M**

**1.** Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH. A Gjakovë, në këtë përbërje:

1. z. Arben Bakalli, i emëruar nga Kryetari i Komunës.
2. znj. Flona Hyseni, përfaqësuese e Kuvendit .
3. z. Naser Brahimaj, përfaqësues i Kuvendit .

**2.** Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

**3. Vendimi iu dërgohet:**

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Anëtarëve të Komisionit.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-18222  
Dt: 20.04.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve, me datë 20.04.2026, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Arben Bakalli, emërohet anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A.
2. Ky vendimi i dërgohet Kuvendit të Komunës për të emëruar edhe dy anëtarë të tjerë nga radhët e Kuvendit, siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i'u dorëzohet:**

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
- Anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- Arkivit.

**Ardian Gjini**

  
Kryetar i Komunës së Gjakovës